Për vitet 2019-2021 të ardhurat e parashikuara për bashkinë Shijak nga taksat e ndara përbëjnë rreth 12% të të ardhurave nga burimet e veta vendore.

Të ardhura nga Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura

Bazuar në ligjin 9975 dt. 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare" të ndryshuar përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, ku pas arkëtimit nga institucione shtetërore në rolin e agjentëve tatimorë, një pjesë e këtyre të ardhurave transferohen në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore sipas përkatësisë ngaburojnë.

Referuar pikës 3, të Nenit 4 të Ligjit 9975, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor në rolin e agjentit tatimor, arkëton detyrimin nga pronari i mjetit për vlerën e taksës për automjetin, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara, 18% e të ardhurave nga kjo taksë kalon për llogari të Bashkinë Shijak.

Planifikimi bëhet nga agjenti tatimor referuar numrit të automjeteve si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara rereferuar të dhënave për nivelet e arkëtimit.

Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Kjo taksë administrohet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Taksa me nivelet sipas Ligjit Nr.9632 paguhet para kryerjes së regjistrimit, nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë

nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit tatimor përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar, ndërsa diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Shijak, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Planifikimi bëhet nga agjenti tatimor si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara rereferuar numrit të procedurave të tjetërsimit të pronës të kryera nga vetë ato.

Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale

Bazuar në Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Neni 25, Pika 2, të ardhurat e arkëtuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore për tatimin mbi të ardhurat personale do të ndahet me njësitë e vetëqeverisjes vendore, dhe 2% e të ardhurave nga kjo taksë kombëtare i kalon përkatësisht Bashkisë Shijak në llogarinë e degës së thesarit
Planifikimi i të ardhurave i referohet realizimit të të ardhurave ndër vite nga agjenti tatimor

Te ardhurat nga Tarifat Vendore

Referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifave vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore; dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj. Gjithashtu bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive, dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.

Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi.

Për vitin 2027-2029 të ardhurat e parashikuara nga tarifave përbëjnë rreth 21.5 % të të ardhurave të veta.

Peshën më të madhe në kategorinë e të ardhurave nga tarifave vendore e zënë të ardhurat nga tarifave për ofrimin e shërbimeve publike si pastrimi e largimi i mbetjeve me 85.8%, ndriçimi publik me 4.3%, tarifave transportit 4.3%.

Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij, e cila shpërndahet dhe paguhet nga familjet dhe bizneset si kontribues dhe përfitues të këtij shërbimi. Për të incentivuar dhe nxitur zhvillimin e disa kategorive të bizneseve, si dhe duke ju referuar nivelit ekonomik-social sipas zonave, ngarkesa e tarifimit është shpërndarë gjithashtu duke u bazuar edhe në:

vendndodhjen (zonë urbane apo zonës rurale),

llojin e aktivitetit (tregti, shërbim, prodhim, profesion i lirë, fermer, transport, ndërtim, karburant, institucion, ofj, etj)

dhe në statusin e subjektit (familjar, biznes i madh, biznes i vogël, institucion shtetëror, ambulant etj).

Parashikimi në rritje i të ardhurave nga biznesi bazohet në rritjen e njësive takapaguese e në evidentimin e kapaciteteve të reja, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës takapaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me takapaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.

Te ardhurat nga tarifat e shërbimeve publike për pastrimin e largimin e mbetjeve, gjelbërimin, ndriçimin publik.

Tarifat familjare për pastrim, ndriçim, dhe gjelbërimin do të shlyhen nga taksapaguesit pane sektorit të Taksava vendore në Bashkinë Shijak për nj.a.Shijak dhe në njesite administrative Xhafzotaj ,Maminas ,Gjepale për banoret e këtyre njesive.

Të ardhura të tjera të bashkisë

Të ardhura nga shërbimet administrative

Nga tarifa për shërbimet administrative që bashkia ofron si ato të drejtorisë të zhvillimit të territorit për aplikimet për leje, kontrole dhe verifikime, për aplikimet për AMTP-të etj si efekt i implementimit të disa tarifave të reja në paketën fiskale, planfikohet rritje prej 5% të ardhura në vit, të cilat parashikohet të mbulojnë tarifat për kostot administrative për shërbimin që i ofrohen subjekteve.

Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit

Plani i të ardhurave të parashikuara me rritje 5% në vit bazohet tek trendi i aplikimeve të tarifave të miratuara nga Ministria e Financave për subjektet që pajisen me liçensën dhe çertifikatën përkatëse për transport udhëtarësh ose mallrash, për vete ose për të tretë.

Të ardhura nga Tarifa për dhënie liçensë për tregtimin të naftës bruto e n/produkteve

Bazuar në VKM Nr. 970, dt 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënie të liçensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, ky zë parashikon rritje prej 1% të ardhura viti nga subjekte me aktivitet tregtim karburanti, që pajisen me liçensën përkatëse.

Të ardhura nga Tarifat e sektorit të pyjeve dhe kullotave

Të ardhurat e parashikuara me rritje 5% në vitin bazohen në trendin e aplikimeve të tarifave të shërbimeve administrative që kryen sektori i pyjeve dhe kullotave.

Të ardhura nga Tarifat e shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri

Të ardhurat e parashikuara me rritje 5% bazohen në nivelin e tarifave të shërbimeve që kryen struktura të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj, si dhe në realizimin e të ardhurave vitet e kaluara nga kjo strukturë.

Të ardhura nga Tarifa për zënien e hapësirave publike

Baza e taksës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m2, e cila vihet

në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit.
Parashikimi i të ardhurave me 5% është bërë duke ju referuar kërkesës në rritje për shfrytëzimin e hapësirave publike brenda juridiksionit të Bashkisë.

C.1 Te ardhura të tjera

Referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 36, te ardhura nga burime te tjera janë: të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë; të ardhurat nga investimet mbi kapitalet; të ardhurat nga titujt dhe të drejtat e tjera të blera nga bashkia; të ardhurat nga fitimi i ndërmarrjeve publike në pronësi; të ardhurat nga partneritetet privat-publik.
Bashkitë krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre ekonomike, qiratë dhe shitja e pronave, interesat, gjobat, kamatvonesat etj.

Të ardhurat nga burime të tjera përbëjnë në total vetëm 2% të të ardhurave nga burimet e veta vendore. Pjesë e rëndësishme në këtë kategori zënë të ardhurat nga kamatvonesat dhe gjobat, nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë, si dhe shitja e mallrave dhe shërbimeve të ndryshme.

Te ardhurat nga kundravajtje administrative/gjobat

Gjobat bazohen në ligjin Nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative":
Bazuar në Nenin 6.b, "Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative parashikohen me akte të këshillit bashkiak, për shkelje që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të veçanta, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre në njësitë territoriale përkatëse, ku, sipas ligjit, ushtrojnë funksionet e veta".
Bazuar në Nenin 10, "Masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative. Masa e dënimit me gjobë mund të jetë fikse apo e përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë. Në rastet kur kundërvajtjet administrative parashikohen në aktet e miratuara nga këshilli bashkiak, masa e dënimit përcaktohet në këto akte.
Ky zë parashikon të ardhurat nga kamatvonesa për mosshlyerje detyrimi në afate ligjore nga bizneset, gjoba nga kontrole dhe inspektime tatimore, gjoba për kundravajtje administrative që mund të vendosen nga Policia Bashkiake, nga Inspektoriati Ndërtimit Vendoretj.

Parashikimi i të ardhurave në vit është bërë duke ju referuar trendit të të ardhurave ndër vite kryesisht nga kamatvonesat për shlyerje pas afatit të detyrimit tatimor të bizneseve, nga gjobat e Policisë Bashkiake dhe nga gjobat e vendosura nga Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

Mbledhja e detyrimeve te prapambetura nje burim I rendesishem ne planifikimin e te ardhurave me te cilat kjo PBA do te shtohet me 45 mije leke te tjera nga 18 mije te planifikuara mesatarisht ne vitet e kaluara..

Planifikimi i Shpenzimeve

Bashkia brenda kapaciteteve financiare dhe prioriteteve strategjike të Planit të Detyruar Vendor, duke mbajtur parasysh kërkesave të qytetarëve në degjese publike realizuar për këto qëllim (relacion i degjesës është pjesë e këtij materiale bashkëngjitur si dokument ku janë vendosur prioritet tyre në pjesë të Projekt Buxhetit 2027-2029, dhe rehabilitime të rrugëve të brendshme në zona të përcaktuara në degjese publike.

Planifikimi i Shpenzimeve sipas programeve

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik

Te detajuara sipas klasifikimit ekonomik, shpenzimet janë sipas tabelës me poshtë.

Programet		2027	2028	2029
		Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)
AA108	Organet ekzekutive dhe legjislativ, për çështjet fin dhe fiskale, çështjet e brendshme			
Pagat dhe sigurimet shoqërore		127,620	127,620	127,620
Të tjera shpenzime korrente		55,999	70,999	72,545
Shpenzimet kapitale		-	7,000	
Tavanet e përgjithshme		183,619	205,619	200,165
AB108	Shërbimet Policore			
Pagat dhe sigurimet shoqërore		39,392	39,392	39,392
Të tjera shpenzime korrente		5,000	5,000	5,000
Shpenzimet kapitale		-	-	-
Tavanet e përgjithshme		44,392	44,392	44,392
AC108	Mbesh dhe Zhv.Ekonomik Vendor, Kullimi dhe Ujitja, Pyjet .			
Pagat dhe sigurimet shoqërore		28,106	28,106	28,106
Të tjera shpenzime korrente		4,500	4,500	4,500

Shpenzimet kapitale		1,000	-	-
Tavanet e përgjithshme		33,606	32,606	32,606
AE108				
Pagat dhe sigurimet shoqërore		73,691	73,691	73,691
Të tjera shpenzime korrente		83,000	83,000	83,000
Shpenzimet kapitale		410,482	356,617	365,432
Tavanet e përgjithshme		567,173	513,308	522,123
AD108	Sporti,Kultura,Arsimi,Kujdesi Social			
Pagat dhe sigurimet shoqërore		145,355	145,355	145,355
Të tjera shpenzime korrente		43,300	49,800	49,800
Shpenzimet kapitale		10,000	20,000	20,000
Tavanet e përgjithshme		198,655	215,155	215,155
Totali Pagat dhe sigurimet shoqërore		414,164	414,164	414,164
Totali Të tjera shpenzime korrente		191,799	213,299	214,845
Totali Shpenzimet kapitale		421,482	383,617	385,432
Totali Tavanet e përgjithshme		1,027,445	1,011,080	1,014,441

Tabela e permbledhur ne vitet 2024-2029 sipas funksionit:

Vitet	Paga	Shp operative	Investime	Shuma
2024	276,399	205,511	134,734	616,644
2025	373,691	210,059	139,278	723,028
2026	414,164	211,520	361,343	987,027
2027	414,164	191,799	421,482	1,027,445
2028	414,164	213,299	383,617	1,011,080
2029	414,164	214,845	385,432	1,014,441

Tabela nr 3 PBA3-Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik

Atehere kostot e perseritura neto per pagat dhe sigurimet dhe kostot operative dhe te mirembajtjes jane si me poshte:

- a) **Kostot administrative/Numri i punonjesve:** Bashkia do te mbeshtese nje strukture te miratuar administrative prej 360 punonjesish te cilet kontribuojne ne programe te ndryshme.me kohe te plote duke perfshire ketu edhe 3 punonjes te gjendjes civile.

Lloji i shpenzimet	Vitet					
	Plani 2024	Plani 2025	Plani 2026	Plani 2027	Plani 2028	Plani 2029
Nr i punonjesve	356	360	360	360	360	360
Kosto administrative /Paga	304,378	373,691	414,164	414,164	414,164	414,164

Shpenzimet per paga dhe sigurime shoqerore do te zene 40% per vitin 2027, 41% per vitin 2028 dhe 41% te totalit te buxhetit per vitin 2029.

Sic shihet ndryshimi I vetem ne kete PBA eshte rritja e fondit te pagave per pjesen e daljes se VKM nr 503 date 01.08.2024“Per disa ndryshime ne VKM nr 328 date 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve,grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”,vendim i cili u miratua edhe nga keshilli i bashkise Shijak me nr 28 date 26.08.2024“ Për ndryshimin e VKB nr 29 date 24.07.2023 mbi miratimin e pagave të punonjësve dhe personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në bashkinë Shijak per vitin 2024”i ndryshuar!

- b) **Shpenzimet operative dhe te mirembajtjes:** Jane shpenzime ne rritje nga viti ne vit. Ato mbeshtesin kontratat kryesore te sherbimit te pastrimit dhe largimit te mbetjeve, mirembajtjes se siperfaqeve te gjelberuara dhe ndricimit publik dhe sherbimet baze te cilat luhaten ne 19-21 % ne 3 vitet e 2027-29 keto ne raport me totalin e buxhetit respektiv, jane te perfshira edhe fondet e transfertave dhe fondet rezerve,perkatesisht nga 13,000 mije leke per vitet 2027-2029.

Lloji i shpenzimet	Vitet					
	Plani 2024	Plani 2025	Plani 2026	Plani 2027	Plani 2028	Plani 2029
Shpenzimet operative	278,090	210,060	215,005	216,792	215,005	216,792
Ne % ndaj totalit te buxhetit	33	29	29	19	21	21

- c) **Kostot kapitale/investimet**

Prioritare do të jene investimet e programit te Transportit (Infrastruktures Rrugore), te cilat ne tre vitet bashke 2027-2029 do te zene 85 %,80 %,93 % brenda zerit te investimeve , ndersa ndaj totalit te buxheteve kemi


Lloji i shpenzimet	Vitet					
	Plani 2024	Plani 2025	Plani 2026	Plani 2027	Plani 2028	Plani 2029
Shpenzimet Investime	258,168	139,279	361,343	421,482	383,617	385,432
Ne % ndaj totalit te buxhetit	21%	19%	36%	41%	38%	38%

TABELA E INVESTIMEVE PER PBA 2027-2029

Nr.	Kodi I N/Programit	Emërtimi I Projektit	2026	2027	2028	2029
				Kapitulli 5	Kapitulli 5	
1	P452-SJ-012	Rehabilitim I rrugeve ne Lagjen Karrec Nj.Ad Maminas 37.277.400	15,000,000		0	0
2	P452-SJ-025	Rikonstruksion I rrugeve te brendshme ne Nj.Ad e	22,398,697			
1	P452-SJ-027	Rehabilitimi I 3 Rrugeve ne Njesite e Bashkise Shijak",Rruga Gjepalaj e Poshteme"Rik i Rruges se" Laleve",dhe Rik I Sheshit prane	37,825,115	37,825,115		
2	P452-SJ-028	Rikonstruksion I 5 Rrugeve te Brendshme, ne njesite e Bashkia Shijak(Rruga Dum Alla,Rruga Oksigjenit,Rruga e Koceve ne Rrubjeke,Rruga e Varrezave ne fshatin Vlashaj,Rruga ne Terzie me KUZ)120.000.000	50,000,000	50,000,000		
3	P452-SJ-029	Rikonstruksion, sistemim - asfaltim rruga "Auto fshati Shetel". Njësia ad Gjepake, 170.170.000	34,034,000	68,068,000	68,068,000	
4	P452-SJ-030	Sistemim , asfaltim I rrugëve " Cizmeli - Eminas". Njësia ad. Gjepake378.474.413	75,694,901	151,389,765	151,389,765	
5	P452-SJ-031	Riparim i shtresave asfaltike rruga Hardhishtë- Gjepalaj. Njesia ad Gjepalaj 65.000.000	13,000,000	26,000,000	26,000,000	
8	P452-SJ-032	Riparim i shtresave asfaltike rruga Gani Keta, bashkia Shijak .6.000.000	6,000,000			
6	P452-SJ-033	Riparim i shtresave asfaltike Rruga Djerr- Rezervuari Metallaj. Njësia ad Maminas.26.000.000	5,200,000	10,400,000	10,400,000	
7	P452-SJ-034	Sistemim , asfaltim I rrugëve ne : lagja e "Re Bodinok" & lagja e Re Metallaj. Njësia ad. Maminas.144.499.000	28,900,000	57,799,600	57,799,600	
8	P452-SJ-035	Sistemim asfaltim i rruges Mustafa Bulku . Njesia ad. Xhafzotaj 10.000.000	6,000,000	4,000,000		
12	P452-SJ-036	Mbikqyrje dhe kolaudime te rrugeve qe do rehabilitohen gjate vitit 2025	12,000,000			
9	P452-SJ-037	Rruge te brendshme ne te gjitha njesite e bashkise Shijak			25,960,000	345,432,000
		Totali I 4520	306,052,713	405,482,480	339,617,365	345,432,000
10	P912-SJ-005	Blerje Paisje elektronike per shkollat	3,700,000			
11	P043-SJ-006	Blerje paisje per Guzhine Gatimi kopeshti " Rilindja"	1,000,000			
10	P822-SJ-002	Arredimi I ambienteve te brendshme te Pallatit te Ri te Kulture	10,000,000	10,000,000	10,000,000	
17	P626-SJ-011	Sherbtimi I Grumbullimit dhe transportit te Mbetjeve te Ngurta	3,700,000			
18	P626-SJ-010	Blerje konteniere (kazane) te galvanizuar per mbetjet urbane per bashkine Shijak.	3,000,000			
11	P626-SJ-006	Shpronësim per varreza ne Nj.Ad te bashkise Shijak	5,000,000	5,000,000	5,000,000	10,000,000
12	P626-SJ-012	Rehabilitim te ambienteve te gjelbera ne qytetin e Shijakut	5,000,000		12,000,000	10,000,000
13	P111-SJ-007	Hartim Projektesh per nevoja te bashkise Shijak ne "Diga+, Rruge+PPV "	4,000,000		7,000,000	
22	P111-SJ-008	Blerje e dy Automjeteve Elektrike	10,000,000			
23	P111-SJ-009	Blerje Paisje digitale per topografin, projektues.	1,000,000			
24	P424-SJ-004	"Rehabilitim dhe Rivitalizim i sip 14.233 m2 ne fshatin Shetel,Nj.Ad Gjepalaj	5,391,000			
14	P426-SJ-001	Zbatim I Projektit te Mbareshtimi I Pyjeve	2,000,000	1,000,000		
26	P043-SJ-005	Rehabilitim I ambienteve ne Qendren Komunitare te femijeve me Aflesi teKufizuar.	1,500,000			
15	P043-SJ-004	Rehabilitim I ambienteve ne Qendren Komunitare per moshat e treta.			10,000,000	
16	P066-SJ-001	Strehimi Social				20,000,000
		Shuma nga Ardhurat Lokale	361,343,713	421,482,480	383,617,365	385,432,000

Programi	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029
Ceshtje Administrative	-	7,000,000	-
Rruge e Rrjete	405,482,480	339,617,365	345,432,000
Sherbime Publike	5,000,000	17,000,000	20,000,000
Kultura	10,000,000	10,000,000	-
Zhvillimi ekonomik/Pyjet	1,000,000	-	-
Ceshtjet Sociale	-	10,000,000	20,000,000
	421,482,480	383,617,365	385,432,000

Paraqitja ne menyre grafike e Investimeve



Sic shihet Investimet nga te ardhurat per vitet 2027-2029 parashikohen ne rritje te gjitha jane investime ne Ndërtim dhe mirëmbajtje rrugesh urbane&rurale, te cilat zene peshen me te madhe te investimeve 96 % per vitin 2027, 88 % per vitin 2028,89 % per vitin 2029.

Atehere kostot e perseritura neto per pagat dhe sigurimet dhe kostot operative dhe te mirembajtjes jane si me poshte:

Kostot administrative/Numri i punonjesve: Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.776 date 19.12.2025 “Mbi percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi”, ne VKM ner 87 date 06.02.2026 “Per disa ndryshime ne vkm nr 326 date 31.05.2023 per pagat e punonjesve mbeshitetes dhe te tjere te speciliteteve te ndryshme te administrates publike”ne VKM nr 103, date 11.02.2026, “Per disa ndryshime ne VKM nr 328 date 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve,grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”

VKM nr 104 date 11.02.2026 “Per miratimin e vlere te seicilit element perberes te pages bruto mujore te punonjesve te sherbimit te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi “, Duke u mbeshetur ne vkm-te e sipercituara dhe duke patur nje numer banoresh prej 48,586, kategoria dhe paga per pozicion na perket sipas tabelës si më poshtë, miratuar ne VKB nr 28 date 26.08.2024“ Për ndryshimin e VKB nr 29 date 24.07.2023 mbi miratimin e pagave të punonjësve dhe personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në bashkinë Shijak per vitin

2024" beshtese nje strukture te miratuar administrative prej 339 punonjesish te cilet kontribuojne ne programe te ndryshme.me kohe te plote dhe perfshihen edhe 24 punonjes me kontrate me kohe te pjesshme qe do te mbulojne sherbimin e pastrimit ne institucionet arsimore te gjithe shkollave ne fshatra.Me shume punonjes i takojne funksionet e transfertave sektoriale (86) ku perfshihen programit te arsimit baze parashkollor ,sektori i sherbimit dhe mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi, gjendja civile .

Shpenzimet operative dhe te mirembajtjes: jane shpenzime qe mbeshtesin kontratat kryesore te sherbimit me te trete nga Sipermarria e sherbimit , te pastrimit dhe largimit te mbetjeve, mirembajtjes se siperfaqeve te gjelberuara, energjia elektrike, pagesa te ambienteve te marra me qera, pagese e keshilltareve dhe kryepleqte,blerje materiale pastrimi, kancelari, shtypshkrime dhe ndricimit publik dhe sherbimet baze te cilat zene keto % ne raport me totalin e buxhetit , ku jane dhe fondet rezerve + kontigjencat .

TAVANET PERFUNDIMTARE 2027-2029			
	2027	2028	2029
	Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)
AE108	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	127,620	127,620	127,620
Të tjera shpenzime korrente	55,999	70,999	72,545
Shpenzimet kapitale	0	7,000	
Tavanet e përgjithshme	183,619	205,619	200,165
AB108	Shërbimet e Policisë Vendore		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	12,861	12,861	12,861
Të tjera shpenzime korrente	1,000	1,000	1,000
Shpenzimet kapitale			
Tavanet e përgjithshme	13,861	13,861	13,861
AB108	Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpetimi		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	26,531	26,531	26,531
Të tjera shpenzime korrente	4,000	4,000	4,000
Shpenzimet kapitale			
Tavanet e përgjithshme	30,531	30,531	30,531
AC108	Zhvillimi Ekonomik Vendor		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	10,983	10,983	10,983
Të tjera shpenzime korrente			
Shpenzimet kapitale			
Tavanet e përgjithshme	10,983	10,983	10,983

AC108		Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	6,062	6,062	6,062	6,062
Të tjera shpenzime korrente	4,500	4,500	4,500	4,500
Shpenzimet kapitale	0	0	0	0
Tavanet e përgjithshme	10,562	10,562	10,562	10,562
AC108		Pyjet		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	11,061	11,061	11,061	11,061
Të tjera shpenzime korrente				
Shpenzimet kapitale	1,000	0	0	0
Tavanet e përgjithshme	12,061	11,061	11,061	11,061
AE108		Rruge e Rrjete		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	66,414	66,414	66,414	66,414
Të tjera shpenzime korrente	7,000	7,000	7,000	7,000
Shpenzimet kapitale	405,482	339,617	345,432	345,432
Tavanet e përgjithshme	478,896	413,031	418,846	418,846
AE108		Sherbimi i Pastrimit		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	1,874	1,874	1,874	1,874
Të tjera shpenzime korrente	76,000	76,000	76,000	76,000
Shpenzimet kapitale				
Tavanet e përgjithshme	77,874	77,874	77,874	77,874
AE108		Sherbime Publike		
Pagat dhe sigurimet shoqërore				
Të tjera shpenzime korrente				
Shpenzimet kapitale	5,000	17,000	20,000	20,000
Tavanet e përgjithshme	5,000	17,000	20,000	20,000
AE108		Ujesjellesi		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	5,403	5,403	5,403	5,403
Të tjera shpenzime korrente				
Shpenzimet kapitale				
Tavanet e përgjithshme	5,403	5,403	5,403	5,403
AD108		Sporti		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	5,860	5,860	5,860	5,860
Të tjera shpenzime korrente	16,000	16,000	16,000	16,000
Shpenzimet kapitale				

Tavanet e përgjithshme	21,860	21,860	21,860
AD108	Kultura		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	10,807	10,807	10,807
Të tjera shpenzime korrente	6,000	10,000	10,000
Shpenzimet kapitale	10,000	10,000	
Tavanet e përgjithshme	26,807	30,807	20,807
AD108	Arsimi parashkollor		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	97,514	97,514	97,514
Të tjera shpenzime korrente	13,000	13,000	13,000
Tavanet e përgjithshme	110,514	110,514	110,514
AD108	Arsimi Mesem		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	4,751	4,751	4,751
Të tjera shpenzime korrente			
Tavanet e përgjithshme	4,751	4,751	4,751
AD108	Cerdhja dhe Qendra Komunitare		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	26,423	26,423	26,423
Të tjera shpenzime korrente	6,500	9,000	9,000
Shpenzimet kapitale		10,000	
Tavanet e përgjithshme	32,923	45,423	35,423
AD108	Sherbimi te Pastreheve		
Të tjera shpenzime korrente	1,800	1,800	1,800
Shpenzimet kapitale			20,000
Tavanet e përgjithshme	1,800	1,800	21,800

Me miratimin e tavanëve të shpenzimeve buxhetore nga keshilli i bashkisë, përgatitet një udhëzim nga kryetari i bashkisë që i drejtohet gjithë drejtuesve ekipit të menaxhimit të programve për përgatitjen e kërkesave buxhetore për hartimin e Projektit të Pare të PBA 2027-2029, dhe në një afat deri më 15 maj këto kërkesa do të analizohen nga Grupi për Menaxhim Strategjik (GMS) pasi janë kryer edhe degjësat publike, duke reflektuar në draftin e parë të buxhetit afatmesëm 2027-2029.

DREJTORESHA EKONOMIKE

Pranvera Alushi

SEKRETARI I KËSHILLIT

Kozeta Doda

JURISTJA

Xhuanë Keçi

KRYETARI I BASHKISË

Elton Arbana

